



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:262282

Datë: 03.02.2020

Numri i dokumentit: 00805325

P.nr.1018/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me sekretaren juridike Kaltrina Krasniqi, ne çështjen penale ndaj të pandehurit K.I nga Gjilani, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313, paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1811/2019 të datës 08.11.2019, të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit Ismet Ukshini, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 22.01.2020 publikisht shpalli, ndërsa më 03.02.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **K.I** nga i ati M..., e ëma M..., e lindur A..., i lindur më ..., në Gjilan, me vendbanim në fshatin ..., Komuna e Gjilanit, me numër personal identifikues:, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i dënuar.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më dt. 05.11.2019, rreth orës 10:02, në Gjilan, në rrugën "Lidhja e Prizrenit", në Qendrën Tregtare "I...", i pandehuri, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka kryer vjedhje në dëm të dëmtuarës, Qendrës Tregtare "I...", në atë mënyrë që ka hy në "I..." dhe ka shkuar te sektori i pijeve alkoolike dhe aty ka marrë një litër uiski të llojit "Jack-Daniels", në vlerë rreth 29.99 € të cilën e fshehtë nën jakne dhe largohet nga marketi pa u vërejtur dhe sërish rreth orës 10:25, kthehet në market dhe përsërika shkuar tek sektori i pijeve alkoolike dhe aty ka marrë edhe një litër uiski të llojit "Jack-Daniels", në vlerë rreth 29.99 € duke e fshehur nën jakne dhe largohet nga marketi pa u vërejtur, me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 59.98 €

-me çka ka kryer veprën penale, **Vjedhja nga neni 313, paragrafi 1 i KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore si dhe neneve, 4,7,17,39,39,40,42,43,69,70,71,72, si dhe nenit 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurin:

E G J Y K O N

Me dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej **gjashtëdhjetë (60) ditë** si dhe **dënim me gjobë** në shumën prej **njëqindpesëdhjetë (150) Euro**, të cilat dënime do të ekzekutohen pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

mirëpo nëse eventualisht i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së i njëjti,

I ZËVËNDËSOHET me dënim me burgim duke ju llogaritur çdo 20 euro të barabartë me 1 (një) dite burgim përkatësisht në kohëzgjatje prej shtatë (7) ditëve ose në mënyrë përpjesëtimore me pjesën e dënimit të gjobës së pa paguar, të cilin dënim duhet ta filloj ta mbaj ne afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga gjykata.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej **njëzet (20) euro**, si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej **tridhjetë (30) euro**, në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari përfaqësuesi i Qendrës Tregtare "I...", Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

1. Rrijdha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 08.11.2019, ka ngritur aktakuzën e lartcekur, ndaj të pandehurit K.I, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313, paragrafi i KPRK-së. Në shqyrtimin fillestar të datës 22.01.2020, në të cilin ishin prezent Prokurori i Shtetit Ismet Ukshini, i pandehuri K.I, në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit deklarohet se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit K.I, për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri K.I, ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313, paragrafi 1 i KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 313 , paragrafi 1 i KPRK-së, Vjedhja konsiderohet:

1. Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënim me burg efektiv dhe me gjobë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë

parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që të pandehurit K.I, si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i njëjti është penduar, më parë nuk ka kryer vepra penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese ka marrë se vepra penale është rrezikshmëria e veprës penale dhe dëmin që i pandehuri i'a ka shkaktuar të dëmtuarës Qendrës Tregtare 'I....'.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit K.I duke marrë parasysh rrethanat e përmendura më lart është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20.00 € (njëzet euro), në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 1018/19 Më datë 03.02.2020

Sekretarja Juridike

Kaltrina Krasniqi

Gjyqtari

Veli KRYEZIU

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të Përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.